



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr.
Br.

VIII-03

Data
Datum

13.01.2021

OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Direkcija za Zdravstvo i Socijalno
Mirotvorno
Department for Health and Sociale Welfare

Në mbështetje të Ligjit të punës nr.03/L-212 neni 8, pika 1 dhe 2, Ligjit të shëndetësië 04/L-125, neni 3, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 dhe statutit të QKMF-së, Drejtoria e DSHMS, me datën 13 janar 2021 shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me orar të plotë:

- I. Mjek i përgjithshëm-----2 pozita,
- II. Mjek specialist Gjinekolog-----1 pozitë,

Vendi i punës: QKMF, QMF, AMF- Obiliq

Kushtet profesionale:

- I- Mjek i përgjithshëm- dy pozita
Koeficienti: H 27
Lloji dhe vendi i punës: i karrierës.
Periudhë provuese 3 muaj me mundësi vazhdimi .

- a) përgatitja superiore-Fakulteti i Mjekësisë, drejtimi i përgjithshëm,
- b) profesioni – Mjek (doktor i mjekësisë),
- c) të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH- Oda e Mjekëve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi,
- ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës në mbikëqyrje të Mjekut Familjar,
- harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar,
- përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë,

- përcjell sistematikisht rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve,
- kujdeset për personat e moshuar dhe në nevojë,
- ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate,
- interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike,
- komunikon ose konsultohet me specialistë të MF sipas nevojës,
- referon pacientin te specialisti i MF dhe për kujdes spitalor,
- tregon kujdes të vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse,
- bën kontrollin e sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike),
- promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete),
- vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi,
- përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë,
- i nënshtrohet programit nacional të ZHVP-së,
- përkujdeset për konfidencialitetin e individit,
- përcjellë sëmundshmërinë nën mbikëqyrje të MF,
- identifikon grupet e veçanta të rrezikut,
- merë pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjellë vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve,
- ndihmon MF në zhvillimin e auditive mjekësore në institucionin përkatës.
- merë pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.

Kushtet profesionale:

II- Mjek specialist Gjinekolog--1 pozitë,

Koeficienti: H-659/1

Lloji dhe vendi i punës: i karrierës.

Periudhë provuese 3 muaj me mundësi vazhdimi

- a) përgatitja superiore- Fakulteti i mjekësisë, Drejtimi Gjinekologji
- b) profesioni- specialist i gjinekologjisë
- c) të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH- Oda e Mjekëve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të kryej të gjitha shërbimet specialistike gjinekologjike.
- Të bëjë edukimin shëndetësor për shëndetin riprodhues
- Të bëjë përcjelljen e shtatëzënisë si dhe shëndetin e femrës edhe pas lindjes.
- Të bëjë koordinimin dhe bashkëpunimin me institucionet publike shëndetësore dhe të aplikoj të arriturat shkencore bashkëkohore në gjinekologji dhe mjekësi në përgjithësi.

- Merr pjesë në takime konsultative, profesionale, komunikon qartë, saktë dhe krijon klimë të mirë pune që rritë kënaqësitë e individit/pacientit dhe familjes.
- Është burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.
- Bashkëpunon me zyrën e Kujdesit Antenatal (KAN)
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrat të Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare
- Për punën e vet i përgjigjet Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare dhe Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare

Të gjithë të interesuarit për konkurrim janë të obliguar të sjellin dokumentacionin e nevojshëm dhe valit (kopje të nostrifikuar-saktësuar):

1. Kërkesën,
2. Licencën e punës,
3. Dokumentin e identifikimit,
4. Diplomën e shkollimit,
5. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që nuk ka ndonjë procedurë hetimore,
6. Certifikata e gjendjes shëndetësore.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit 13.01.2021 deri më 28.01.2021.

Kërkesa për konkurrim merret dhe dorëzohet në zyrën pritëse në objektin e Komunës, Obiliq (nga ora 8:00 – 15:30)

Rruga “ Hasan Prishtina “ 15000.

Dokumentacioni i cili i bashkëngjitet aplikacionit duhet të jetë kopje i nostrifikuar.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do të thirren në testim.

Dokumentacioni i cili nuk i`u përgjigjet kërkesave dhe specifikave të konkursit si dhe dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai që mbërrin me vonesë nuk do të shqyrtohet.



Drejtori i DSHMS

Vlora Kabashi